



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
ISBOLETINI
REKTORATI

Pranuar me dt 28.03.2019			
Njesia org	Numeri	Nr ekzempl	Vlera
	528		

Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”

Rregullore Mbi Zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit

Mitrovicë
mars 2019

Në mbështetje të nenit 23 të Statutit, si dhe në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës dhe nenin 3 pika 1 nënpika 1.1 të Udhëzimit Administrativ të MASHT – it 03/2015 Mbatja e zgjedhjeve studentore dhe zgjedhja e organeve dhe këshillave në njësi akademike në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB), Këshilli Drejtues (KD) në mbledhjen e mbajtur me datën. 28.3.2019, miratoi:

Rregullore

Mbi Zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit

Neni 1

Me këtë Rregullore do të rregullohet procedura e zgjedhjeve në Këshillat e Fakulteteve të UMIB – it, si dhe mënyra e punës së tyre.

I. Procedurat e zgjedhjeve në Këshill të Fakultetit

Neni 2

Përbërja e Këshillit të Fakultetit duhet të jetë konform nenit 74 të Statutit të UMIB – it dhe dispozitave të kësaj rregullore..

Neni 3

(1) Zgjedhjet për anëtarë të Këshillit të Fakultetit bëhen në bazë të listës prioritare të votave të fituara sipas kësaj procedure:

1. Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Fakultetit nga radhët e profesorëve (profesor i rregullt, profesor i asocuar dhe profesor asistent), të drejtë vote kanë të gjithë profesorët që janë në marrëdhënie të rregullt (primare) pune në fakultet.
2. Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Fakultetit nga radhët e asistentëve, të drejtë vote kanë të gjithë profesorët dhe asistentët që janë në marrëdhënie të rregullt (primare) pune në fakultet.
3. Për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Fakultetit nga radhët e administratës, të drejtë vote ka i tërë personeli jo – akademik në marrëdhënie të rregullt pune në fakultet¹.
4. Një përfaqësues nga radha e studentëve në Këshillin e Fakultetit, zgjidhet sipas propozimit të Këshillit të Studentëve të Fakultetit, konform dispozitave të Rregullores mbi zgjedhjet e studentëve.
5. Sekretari i fakultetit është anëtarë ex officio i Këshillit të Fakultetit me të drejtë vote.

(2) Nuk kanë të drejtë të zgjidhen apo të zgjedhin të gjithë kandidatët të cilët bien ndesh me nenin 150 të Statutit të UMIB – it dhe nenin 17.3 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për shkak se një gjë e tillë kualifikohet si konflikt interesi.

¹Përfshijmë, në Fakultetin e Edukimit dhe Fakultetin Juridik, në mungesë të stafit administrativ në marrëdhënie të rregullt pune, të drejtë vote dhe kandidimi për anëtar të Këshillit ka edhe stafi me kontratë për marrëveshje të veçanta për periudhën që e ushtron këtë pozitë.

Verifikimi i mandateve

Neni 4

- (1) Këshilli i Fakultetit në mbledhjen e parë bënë verifikimin e mandateve të anëtarëve të këshillit të fakultetit në bazë të raportit të sekretarit të fakultetit për rregullsinë e zgjedhjeve të anëtarëve të këshillit të fakultetit, me propozim për verifikimin e mandatit.
- (2) Votimi për raportin bëhet në tërësi nëse nuk është kontestuar asnjë mandat, në rast se ndonjë mandat kontestohet, së pari votohet për të gjitha mandatet e pakontestueshme, e pastaj votohet për çdo mandat të kontestueshëm veç e veç.
- (3) Nëse Këshilli i Fakultetit konstaton se zgjedhja është bërë në mënyrë jo të rregullt, kërkohet që zgjedhja e kontestuar të përsëritet.
- (4) Anëtarit të Këshillit të Fakultetit që i është kontestuar ose i është shtyrë vendimi për verifikimin e mandatit, ka të drejtë të vazhdojë pjesëmarrjen në mbledhje por pa të drejtë vote.
- (5) Pas verifikimit të mandatit, anëtarët e Këshillit të Fakultetit e nënshkruajnë deklaratën etike si vijon: Deklaroj se do ti kryej detyrat me nder dhe me besnikëri, me drejtësi dhe pa anim, me ndërgjegje dhe përgjegjësi, se do t'i përfaqësoj me ndërgjegje dhe përkushtim interesat e Universitetit dhe se do t'i përmbahem Statutit të Universitetit.

II. Zgjedhja e përfaqësuesit të Senatit

Neni 5

- (1) Përfaqësuesi i fakultetit në Senat, zgjidhet me shumicën absolute, nga radhët e personelit akademik (profesor dhe asistentë) në marrëdhënie të rregullt (primare) pune në fakultet.
- (2) Për zgjedhjen e përfaqësuesit të fakultetit nga alineja paraprake, të drejtë vote ka i tërë personeli akademik në marrëdhënie të rregullt punë (primare) në fakultet.
- (3) Përfaqësuesi në Senat, i stafit jo – akademik, zgjidhet me shumicën absolute nga radhët e personelit jo – akademik në marrëdhënie të rregullt pune në të gjitha njësitë akademike të UMIB – it.
- (4) Për zgjedhjen e përfaqësuesve të stafit jo – akademik nga alineja paraprake, të drejtë vote ka i tërë personeli jo – akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UMIB.

III. Kandidimi

Neni 6

Të gjithë të interesuarit për tu zgjedhur në Këshill të Fakultetit dhe në Senat paraprakisht duhet të paraqiten për kandidaturë, sipas dinamikës së zgjedhjeve në UMIB.

IV. Zgjedhja e kryesuesit të përkohshëm të Këshillit të Fakultetit dhe përfaqësuesit Dekan në Senat.

Neni 7

(1) Kryesuesi i përkohshëm i Këshillit të Fakultetit zgjidhet nga kandidatët e propozuar të Këshillit të Fakultetit me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit të Fakultetit.

(2) Nëse asnjë nga kandidatët e propozuar nuk e merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, atëherë organizohet radha e dytë e votimit vetëm për kandidatin me numër më të madh të votave. Nëse kandidati nuk merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, në radhën e dytë, konsiderohet se kandidati është refuzuar dhe Këshilli i Fakultetit është i obliguar të propozoj kandidat tjetër.

(3) Në rast të votave të barabarta, votimi përsëritet.

(4) Kryesuesi i përkohshëm i KF, është edhe përfaqësues i dekanit të fakultetit në Senat deri në zgjedhjen e dekanit.

V. Mbledhjet

Neni 8

(1) Dekani i Fakultetit (në vijim si "Kryesues") thërret dhe kryeson mbledhjen.

(2) Në rast se Dekani mungon, mbledhjen e përgatit dhe e kryeson prodekani. Nëse edhe prodekani nuk ka mundësi të marr pjesë në mbledhje, mbledhjen e Këshillit të Fakultetit e kryeson anëtari më i vjetër.

(3) Kryesuesi mbledhjet i thërret sipas nevojës. Gjatë periudhës së rregullt të studimeve, mbledhjet e Këshillit të Fakultetit mbahen së paku njëherë në muaj.

(4) Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të mbahen në çfarëdo kohe sipas procedurave të parapara. Rendi i ditës për këtë mbledhje duhet të jetë i kufizuar në një pikë kryesore. Në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit mund të vendosët për thirrjen e ndonjë mbledhje të ardhme të Këshillit të Fakultetit, në këtë rast anëtarët e Këshillit të Fakultetit që nuk janë të pranishëm duhet të ftohen posaçërisht.

(5) Në rast të shkarkimit të Dekanit apo Prodekanit, procedurën e zgjedhjes e organizon anëtari më i vjetër i Këshillit pa asnjë vonesë.

(6) Mbledhjet e Këshillit të Fakultetit janë të hapura për publikun, pos në rastet kur Këshilli i Fakultetit vendos ndryshe.

(7) Anëtarët e Këshillit të Fakultetit ftohen së paku tri ditë para mbledhjes. Ftesat mund të bëhen me shkrim, me fax, e – mail ose në çfarëdo forme tjetër teknike, me të cilën dërgesa dhe informimi janë të sigurta.

(8) Kryesuesi ka të drejtë në çfarëdo kohe të ftojë ekspert, ose të ftojë persona të tjerë në mbledhje.

(9) Kryesuesi është i obliguar të thërras mbledhjen e Këshillit të Fakultetit nëse këtë e kërkojnë së paku 1/3 e anëtarëve të Këshillit të Fakultetit dhe nëse qëllimi është i arsyetuar me shkrim. Nëse kryesuesi i Këshillit të Fakultetit nuk i përgjigjet kërkesës brenda tri ditësh

nga dita e marrjes së kërkesës, mbledhjen e Këshillit të Fakultetit e thërret anëtari më i vjetër i Këshillit të Fakultetit.

VI. Pjesëmarrja në mbledhje dhe përfaqësimi

Neni 9

(1) Të gjithë anëtarët e Këshillit të Fakultetit kanë të drejtë dhe janë të obliguar të marrin pjesë ne mbledhjet e Këshillit të Fakultetit.

(2) Gjatë mbledhjeve të Këshillit të Fakultetit, anëtarët duhet të votojnë personalisht, delegimi i votës nuk lejohet.

(3) Para se të filloj mbledhja e Këshillit të Fakultetit anëtarët do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtari i Këshillit të Fakultetit mund të mungojë nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje anëtari i Këshillit të Fakultetit duhet të njoftojë me kohë kryesuesin.

Neni 10

(1) Për një anëtarë të Këshillit të Fakultetit konsiderohet se tangon me konflikt interesi, në pajtim me rregullativën juridike të Kosovës dhe Statutin e Universitetit, nëse bie ndesh me interesin e tij publik, familjar dhe operacional.

(2) Nëse Këshilli i Fakultetit nuk vendos ndryshe, anëtari në konflikt interesi duhet të lëshojë mbledhjen gjatë asaj kohe kur ajo çështje diskutohet.

(3) Anëtari në konflikt interesi nuk ka të drejtë vote për çështjen përkatëse.

VII. Fillimi i mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës

Neni 11

(1) Kryesuesi e hap, e kryeson, e ndërpret dhe e përfundon mbledhjen.

(2) Për përgatitjen e materialeve për mbledhjen e Këshillit të Fakultetit kujdeset kryesuesi në koordinim me prodekanët dhe sekretarin e fakultetit dhe me shërbimet administrative përkatëse.

(3) Kryesuesi është i obliguar që në rend të ditës të përfshijë propozimet e arsyetuara me shkrim 72 orë para mbajtjes së mbledhjes. Propozimet me shkrim mund të dërgohen personalisht ose me e – mail dhe të nënshkruara nga parashtruesi.

(4) Në fillim të mbledhjes, kryesuesi konstaton se a ka kuorum, propozon rendin e ditës, hap diskutimin rreth rendit të ditës, konstaton miratimin e rendit të ditës.

(5) Kryesuesi ia jep fjalën diskutuesit, konstaton mbylljen e shqyrtimit të temës së caktuar, çështjen e vë në votim, konstaton miratimin ose refuzimin e propozimit, ndërmerr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së punës në mbledhje, konstaton përfundimin e mbledhjes dhe ndërmerr veprime tjera të nevojshme për udhëheqjen dhe drejtimin e mbledhjes konform me këtë rregullore.

(6) Anëtarët e Këshillit të Fakultetit kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës duke e arsyetuar propozimin.

(7) Materialet ose kërkesat të cilat bashkëngjiten gjatë mbledhjes ato mund të miratohen me shumicën absolute të votave.

VIII. Ecuria e mbledhjes

Neni 12

(1) Pas miratimit të rendit të ditës, kalohet në shqyrtim dhe vendosje për çështjet që janë në kuadër të pikave të miratuara të rendit të ditës.

(2) Raportin dhe arsyetimin për secilën pikë të rendit të ditës e paraqet kryesuesi ose personi i caktuar nga kryesuesi, pas të cilit kryesuesi e hap diskutimin.

(3) Të gjithë anëtarët e pranishëm të Këshillit të Fakultetit mund të marrin pjesë në diskutim dhe ti paraqesin mendimet dhe propozimet lidhur me çështjet që do të vendosën në mbledhje.

(4) Kryesuesi i jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim. Në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit askush nuk mund të diskutojë pa e marrë fjalën nga kryesuesi i mbledhjes.

(5) Kryesuesi është përgjegjës për respektimin e këtyre procedurave të punës për veprimet dhe sjelljen e anëtarëve sipas radhës.

(6) Për çdo pikë të rendit të ditës pjesëmarrësit mund të diskutojnë më së shumti dy herë, herën e parë deri pesë minuta, herën e dytë deri dy minuta.

(7) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë nga folësit që t'i përmbahen temës.

(8) Pjesëmarrësi i cili e merr fjalën është i obliguar ti përmbahet çështjes që është në shqyrtim. Çdo pjesëmarrës që konsideron se lidhur me fjalën e tij është shtrembëruar ndonjë fakt, me lejen e kryesuesit ka të drejtë të paraqitet për replikë menjëherë pasi të përfundoj diskutimin pjesëmarrësi ndaj të cilit është paraqitur replika. Replika për të njëjtën çështje i lejohet pjesëmarrësit në diskutim vetëm dy herë dhe sipas rregullit mund të zgjatë më së shumti dy minuta.

(9) Kryesuesi ka të drejtë të ndërpresë mbledhjen më së shumti 30 minuta. Me pajtimin e Këshillit të Fakultetit kjo mund të zgjatet.

(10) Kryesuesi është i obliguar të ndërpresë mbledhjen nëse ai vetë nuk ka mundësi ta udhëheqë në mënyrë të drejtë.

Neni 13

Këshilli i Fakultetit në bazë të propozimit të kryesuesit ose të ndonjë anëtari të Këshillit të Fakultetit mund të vendosë që shqyrtimi për disa çështje specifike të ndërpritet dhe të përgatitet më hollësisht për mbledhjen e ardhme.

IX. Kërkesat dhe ankesat

Neni 14

- (1) Çdo anëtarë i Këshillit të Fakultetit ka të drejtë të parashtoj kërkesë – ankesë për temën e caktuar.
- (2) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë që kërkesa – ankesa të parashtrohet me shkrim.
- (3) Kërkesat – ankesat për rregullat procedurale duhet të arsyetohen shkurtimisht. Me kërkesë një folës për dhe një folës kundër, mund të marrin fjalën. Kërkesat – ankesat për rregullat e procedurës mund të parashtrohen për dy arsye:
 - a) Kërkesa për mbylljen e listës së folësve të regjistruar, nëse kërkesa miratohet me shumicë të thjeshtë, vetëm folësit e regjistruar në listë gjatë parashtresës së kërkesës do të kenë të drejtë të marrin fjalën.
 - b) Kërkesa për përfundimin e shqyrtimit, nëse kërkesa miratohet me shumicën e anëtarëve të pranishëm, diskutimi mbaron dhe kërkesat tjera votohen.

X. Vendimmarrja – votimi dhe zgjedhja

Neni 15

- (1) Vendimet e Këshillit të Fakultetit janë të plotfuqishme me kuorumin minimal prej së paku 50%+1 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
- (2) Para votimit kryesuesi formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me atë pikë të rendit të ditës.
- (3) Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, sipas pikës së rendit të ditës Këshilli i Fakultetit merr vendim ose konkluzion.
- (4) Vendimet e Këshillit të Fakultetit merren me shumicën e votave të numrit të anëtarëve të pranishëm.
- (5) Nëse ka më shumë propozime të vendimeve ose të konkluzioneve, së pari votohet për ato në material ose propozimet nga autoritetet e fakultetit, pastaj për propozime tjera.
- (6) Votimi bëhet me aklamacion, duke ngritur dorën apo me votën e fshehtë. Kjo vendosët në takimin e Këshillit të Fakultetit.
- (7) Votimi bëhet “për”, “kundër” dhe “abstenim”.
- (8) Në rast të numrit të votave të barabarta, vota e kryesuesit është vendimtare)

Neni 16

- (1) Procedurën e votimit të fshehtë e zbaton komisioni i emëruar nga Këshilli i Fakultetit i përbërë prej tre anëtarëve.
- (2) Pas votimit, në bazë të rezultateve të votimit, kryesuesi, përkatësisht kryetari i komisionit, konstaton se propozimi i vendimit ose konkluzioni është miratuar ose është refuzuar.

Neni 17

- (1) Votimi me vota të fshehta bëhet për:

- a. Zgjedhjen e Dekanit për miratim nga Senati.
 - b. Zgjedhja e kryesuesit të përkohshme të Këshillit të Fakultetit i cili do të jetë edhe përfaqësues dekan në Senat.
 - c. Çështjet që prekin intimitetin e ndonjërit nga anëtarët e Këshillit të Fakultetit
 - d. Çështjet kur kryesuesi kërkon votim të fshehtë.
- (2) Numërimi i votave për këto çështje bëhet nën mbikëqyrjen e sekretarit të fakultetit.

XI. Zgjedhja e Dekanit – propozim për miratim nga Senati

Neni 18

- (1) Dekani i Fakultetit zgjidhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit për miratim nga Senati.
- (2) Çdo anëtarë i Këshillit të Fakultetit ka të drejtë të bëjë propozime për kandidatë për pozitën e Dekanit. Propozimet për kandidatë duhet të jenë të arsyetuara mirë dhe të përfshijnë edhe një biografi të shkurtë për kandidatin. Nominimi i kandidatëve për dekan bëhet me shumicën relative, me votim të hapur për secilin kandidat veç e veç.
- (3) Për kandidatët e nominuar organizohet votimi i fshehtë.
- (4) Nëse asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk e merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, atëherë radha e dytë e votimit bëhet vetëm për kandidatin me numër më të madh të votave. Nëse kandidati nuk merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, në radhën e dytë, konsiderohet se kandidati është refuzuar dhe Këshilli i Fakultetit është i obliguar të propozoj kandidat tjetër.
- (5) Në rast të votave të barabarta, votimi përsëritet.

XII. Mbajtja e rendit në mbledhje

Neni 19

- (1) Për mbajtjen e rendit në mbledhje kujdeset kryesuesi i mbledhjes.
- (2) Kryesuesi dhe pjesëmarrësit në mbledhje të Këshillit të Fakultetit janë të obliguar që ti përmbahen rregullave dhe procedurave të mbledhjes.
- (3) Për shkeljen e rendit të mbledhjes mund të shqiptohen këto masa:
 - Vërejtje
 - Marrja e fjalës
 - Largimi nga mbledhja

Neni 20

- (1) Vërejtja me gojë mund ti shqiptohet të pranishmit nëse me sjelljen dhe me diskutimin e tij e çrregullon dhe pengon punën normale të mbledhjes.
- (2) Marrja e fjalës i shqiptohet anëtarit nëse me sjelljet dhe me deklaratën e tij çrregullon punën normale të Këshillit të Fakultetit për të cilën më parë i është shqiptuar vërejtja.
- (3) Vërejtjen dhe marrjen e fjalës e shqipton kryesuesi.

(4) Largimi nga mbledhja i shqiptohet pjesëmarrësit nëse edhe pasi ti merret fjala pengon mirëvajtjen e mbledhjes.

(5) Largimin nga mbledhja e shqipton Këshilli i Fakultetit me shumicë votash. Pjesëmarrësit të cilët i është shqiptuar kjo masë, është i detyruar që menjëherë të largohet nga mbledhja. Largimi nga mbledhja bëhet vetëm për atë mbledhje.

XIII. Procesverbali nga mbledhja

Neni 21

(1) Në çdo mbledhje të Këshillit të Fakultetit mbahet procesverbali. Procesverbalin e nënshkruajnë kryesuesi dhe procesmbajtësi.

(2) Procesverbali duhet të përmbajë këto elemente.

- a. vendin, datën, kohën e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes.
- b. rendin e ditës.
- c. listën e pjesëmarrësve dhe atyre që mungojnë.
- d. të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse.
- e. shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes.

Dokumentet shtesë duhet ti bashkëngjitën procesverbalit.

(3) Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave pas mbledhjes së Këshillit të Fakultetit dhe si ekstrakt duhet të dërgohet anëtarëve të Këshillit të Fakultetit me rastin e dërgimit të materialit për mbledhjen e ardhme.

(4) Procesverbali miratohet në mbledhjen e radhës.

(5) Procesverbali ruhet në arkiv të Fakultetit, me materialet e shqyrtuara sipas pikave të rendit të ditës si dokumente afatgjata.

XIV. Aktet e Këshillit të Fakultetit

Neni 22

(1) Këshilli i Fakultetit nxjerr

- vendime
- konkluzione
- rekomandime

(2) Këshilli i Fakultetit i jep interpretim autentik dokumenteve që i lëshon.

(3) Procesmbajtësi është i obliguar ti përgatit vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet nga mbledhja e Këshillit të Fakultetit, ndërsa rregulloret i përgatitë komisioni përkatës.

Neni 23

Dispozitat e këtyre rregullave dhe procedurave vlejnë për të gjithë anëtarët e Këshillit të Fakultetit dhe për personat tjerë të ftuar apo të angazhuar në Këshillin e Fakultetit.

Neni 24

Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore dhe procedurë zbatohen dispozitat e Statutit dhe akteve tjera ligjore.

XV. Dispozitat përfundimtare

Neni 25

- (1) Për zbatimin e drejtë të kësaj Rregulloreje kujdeset kryesuesi i Këshillit të Fakultetit
- (2) Interpretimin autentik të kësaj rregullore e bënë Këshilli Drejtues.
- (3) Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli Drejtues.

Neni 26

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja nr. prot. 241 e datës 12.03.2015.

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje mund të bëhet sipas së njëjtës procedurë të miratimit.



Prof. dr. Ali Topalli

Kryesues i KD